



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 dhjetor 2016
Nr. ref.:RK1023/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI113/16

Parashtrues

Shukri Maxhuni dhe Gazmend Muqolli

Kërkesë për interpretimin e nenit 7 (E drejta për blerjen e banesës) të Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, të 12 janarit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shukri Maxhuni dhe Gazmend Muqolli nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë ndonjë vendim konkret të një autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për interpretimin e nenit 7 (E drejta për blerjen e banesës) të Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore (në tekstin e mëtejme: Ligji për banesa), të 12 janarit 2012.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 shtator 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 25 tetor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kopjen e kërkesës ia dërgoi Gjykatës Themelore në Prishtinë.
8. Më 16 nëntor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës duket se gjatë viteve të 90-ta, Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë inicioi ndërtimin e disa objekteve banesore.
10. Pas vitit 1999, pa autorizim ligjor, parashtruesit e kërkesës uzurpuan banesa të Ndërmarrjes Publike Banesore.
11. Në një moment të caktuar, me qëllim të lirimit të banesave nga uzurpatorët jolegjitim, Ndërmarrja Publike Banesore inicioi procedura të përmbartimit në Gjykatën Themelore të Prishtinës.
12. Më 29 korrik 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, në pajtim me nenin 3 paragrafi 5, dhe në pajtim me nenet 282 dhe 284 paragrafi 1 dhe 4, të Ligjit për procedurën përmbartimore (Ligji nr. 04/L-139) duke u bazuar në Aktvendimin (E. nr. 82/09) të 31 gushtit 2009, nxori 'Konkluzionin' për zbatimin e lirimit të një numri të këtyre banesave, duke i larguar banorët nga njerëzit dhe sendet e tyre.

13. Në konkluzionin (E. nr. 82/09) të Gjykatës Themelore theksohet: “... me dt: 29.08.2016 duke filluar në ora 10:00, do të bëjë zbrazen dhe lirim nga njerëzit dhe sendet të banesave: 1.nr.13, 2.nr.14, 3.nr.15, 4.nr.16, 5.nr.17 dhe 6.nr.18, të cilat gjenden në adresën "Dardania". objekti 9/4, hyrja I, kati i III-të, të cilat pasi të lirohen nga njerëzit dhe sendet, do t'i dorëzohen në posedim dhe shfrytëzim të lirë kreditorit të përmbarimit”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në banesa janë vendosur pas vitit 1999, që ato banesa i kanë adaptuar vetë për të cilat kanë investuar mjete të konsiderueshme financiare dhe se tani nuk kanë ku të shkojnë.
15. Parashtruesit ekskluzivisht dhe shprehimisht kërkojnë nga Gjykata të bëjë interpretimin e nenit 7 (E drejta për blerjen e banesës) të Ligjit për banesa. Ky nen parasheh:

“Çdo bartës i së drejtës banesore, përkatësisht shfrytëzues i banesës në pronësi shoqërore apo publike, përveç në rastet nga neni 11 i këtij ligji, duhet të paraqesë kërkesë me shkrim për blerjen e banesës”.

16. Parashtruesit, gjithashtu, kërkojnë nga Gjykata që të japë përgjigjen në pyetjen “A kanë të drejtë banorët e lartcekur për t'i blerë banesat me anë të këtij Ligji”?

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizua.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Më tej, Gjykata i referohet nenit 47.1 të Ligjit, i cili parasheh:

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

20. Në fund, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar”.

21. Siç është përmendur më lart, çfarë kërkojnë parashtruesit është interpretimi i nenit 7 (E drejta për blerjen e banesës) të Ligjit për banesa, duke arsyetuar *“se me aplikimin e këtij neni të ligjit, atyre u mohohet e drejta për t'i blerë banesat, meqë ata një kohë të gjatë jetojnë aty”*.
22. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre të kryera nga autoritetet publike, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.1 të Ligjit.
23. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dorëzuar asnjë informacion në lidhje me ndonjë procedurë ligjore apo procedurë tjetër të iniciuar nga ta me qëllim të zgjidhjes së ankesave të tyre, apo lidhur me pretendimin për aplikimin e gabuar të nenit 7 të Ligjit për shitjen e banesave.
24. Çfarë kërkojnë parashtruesit në fakt është *“interpretimi autentik”* i nenit 7 të Ligjit për shitjen e banesave, pasi që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, si rezultat i zbatimit të nenit 7 nga autoritetet kompetente, ata dhe banorët e tjerë janë vënë *“në pozitë të pafavorshme dhe degraduese si në aspektin ekonomik ashtu edhe moral”*.
25. Gjykata rikujton që vetëm autoritetet e përmendura si në paragrafët 2, 3, 4, 5, dhe 8 të nenit 113 të Kushtetutës, janë palë të autorizuar të kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji ose të dispozitave specifike të një ligji.
26. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar të kërkojnë interpretimin e nenit 7 të Ligjit. Interpretimi i Ligjit është çështje e ligjshmërisë, dhe si i tillë është çështje për gjykatat e rregullta, përveç kur interpretimi i gjykatave në rrethana të veçanta të rastit qon në një rezultat qartazi arbitrar. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme.
27. Si përfundim, nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar dhe në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.1 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2016, njëzëri


VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi

